



**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosova - Republic of Kosovo*  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice*  
**Shërbimi Korrektues i Kosovës / Korrektivna Sluzba Kosova / Kosovo Correctional Service**  
*Drejtoria Qendrore - Prishtinë*

## **Shërbimi Korrektues i Kosovës**

### **Rregull e brendshme**

### **Tretmanet për të dënuar**

Shtator 2019

## Neni 1

### Qëllimi

Kjo rregull e brendshme ka për qëllim të sqarojë procedurat e klasifikimit dhe vendosjes së personave të dënuar në Institucionet Korrektuese në bazë të tretmanit.

## Neni 2

### Misioni i Shërbimit Korrektues i Kosovës

Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë Penale dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet e aplikueshme në Kosovë synon të korrektoj dhe ri socializoj të dënuarit, duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën, religjionin si dhe të sigurojë ambient të sigurt për stafin, të dënuarit dhe shoqërinë.

## Neni 3

### Përlafizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

1.1 Tretman - nënkupton organizimin e jetës së përditshme të të dënuarve duke përfshirë aktivitetet që synojnë arsimimin, trajnimin profesional, punësimin për zhvillim personal dhe social të dënuarit si dhe përgatitja e tij për lirin.

1.2 T dënuar - nënkupton personin i cili është dënuar me aktgjykim të formës së prerë nga gjykata kompetente;

1.3 IK - nënkupton Institucionin Korrektues.

1.4 Ekipi multiprofesional - nënkupton ekipin multiprofesional të Institucionit Korrektues që përbëhet nga profesionist të fushave të ndryshme të angazhuar në rehabilitimin dhe risocializimin e personave të dënuar.

1.5 Ekipi profesional i pavijonit - nënkupton ekipin multiprofesional të pavijonit në Institucionin Korrektues që përbëhet nga profesionist të fushave të ndryshme të angazhuar brenda pavijonit.

1.6 KKB - nënkupton komisionin për klasifikimin e rrezikshërisë së dënuarve

## Neni 4

### Vendosja e personave të dënuar në Institucionet Korrektuese

1. Çfarë vendosjes së personit të dënuar në institucionin e veçantë korrektues ose në njësi të veçantë të Institucionit Korrektues duhet të merren parasysh: moshë e tij, llojet dhe pesha e dënimt, dënimet e mëparshme (nëse ka pasur), shëndeti fizik dhe mendor, rekomandimet prej autoriteteve

relevante për trajtim të veçant, lokacioni i vendqëndrimit apo vendbanimit të familjes së tij, siguria, si dhe arsyet lidhur me arsimimin ose punën që mund të jenë të rëndësishme për ri integrimin e tij shoqëror.

2. Gjatë vendosjes duhet të merret parasysh mundësia për zbatimin e programeve të përbashkëta riedukuese si dhe nevoja për shmangien e ndikimeve negative.

3. Përsonat e dënuar meshkuj dhe femra vendosen ndarazi. Gratë shtatëzëna dhe nënat me fëmijët e tyre vendosen ndarazi nga gratë e tjera të dënuara.

4. Personat e dënuar vendosen ndarazi në Institucion nga personat e paraburgosur.

5. Duhet bërë përpjekje që personat e dënuar për herë të parë të ndahen nga personat të cilët më parë kanë mbajtur dënimin me burgim (recidivistët).

6. Të dënuarve me sëmundje mentale duhet t'u ofrohet përkujdesje apo trajtim i veçantë në IK apo në insitucione të specializuara të shëndetit mental. Andaj, ata duhet të ndahen nga pjesa tjetër e popullatës dhe të mbahen nën mbikqyrje të shtuar.

7. Të dënuarit të cilët transferohen nga një IK në Institucionin tjetër, fillimisht vendosen në tretmanin e pranimit ku brenda periudhës prej shtatë (7) dite, pas vlerësimit të ekipit multiprofesional mund të vendoset në tretmanin paraprak.

#### Neni 5

##### Planifikimi i dënimit – Plan individual

1. Planifikimi i dënimit është bazë për klasifikimin e tretmaneve për personat e dënuar.
2. Njësia përkatëse për vlerësim e bën planifikimin e dënimit për secilin të dënuar sipas procedurave përkatëse për planifikim të dënimit i cili do të zbatohet në IK.

#### Neni 6

##### Tretmanet

1. Qëllimi i tretmaneve është që të dënuarit të motivohen për sjellje të mira dhe të stimulohen që të jenë pjesë e planifikimit të dënimit dhe procesit të risoializimit.
2. Çdo nivel i tretmanit duhet të ofrojë programe adekuate që mundëson aktivitetet dhe privilegjet të ndryshme të cilat duhet të ndikojnë në përgaditjen e tyre për jetë në liri.
3. Llojet e tretmanëve të parapara me këtë rregull duhet të zbatohet për të gjithë të dënuarit madhor, si për meshkuj ashtu edhe për femra, të cilët janë dënuar me burgim dhe me burgim afatgjatë.



## Neel 7

### Kriteret e tretmaneve

1. Secili tretman ofron një varg privilegjesh dhe stimulimesh të ndryshme që rriten me avancimin e të dënuarit. Zakonisht të dënuarit në tretmanin themelor do të marrin minimumin e garantuar me ligj të të drejtave që i'u takojnë.
2. Të dënuarit në tretmanin standard dhe të avancuar do të marrin progresivisht më shumë privilegje, edhe pse saktësisht natyra e secilit privilegj do të varet sipas sigurisë së secilit IK.
3. Pa marrë parasysh tretmanin në të cilin është vendosur i dënuari, atij do t'i ipet o drejta të participojë në aktivitetet e IK, që do t'i ndihmojë të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë dhe vetëbesimit.
4. Metodatat për inkurajim të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së të dënuarve në tretmanet e tyre duhet të zhvillohen.
5. Mbajtja e të dënuarit në cilin do nivel të tretmanit por edhe ngritja apo ulja (degradimi) e tij varet nga sjellja dhe performanca e të dënuarit.
6. Me sjellje dhe performancë të mirë do të vlerësohet si:

- 6.1 Higjiena personale, paraqitja dhe veshja e përshtatshme;
- 6.2 Respektim i rregullave të institucionit;
- 6.3 Përpjekjet dhe arritjet në punë dhe aktivitete tjera konstruktive si p.sh: pjesmarje e rregullt në planifikim dënim; aplikim dhe arritjet në edukim (duke përfshirë edhe trajnimet/kurset profesionale), qëndrim konstruktiv dhe dëshirë për të përfituar nga programet kryesore për trajtim, si p.sh: të kontaktojë me stafin e programeve, të kuptojë rëndësinë e programeve dhe t'i shfrytëzojë mundësitë që japin programet për nevojat e vetë;
- 6.4 T'i përkrahë përpjekjet e të dënuarve tjerë që të angazhohen në planifikimin e tyre të dënimit; që të adresojnë sjelljen e tyre kundërligjore e të bëjnë një jetë më konstruktive;
- 6.5 Sjellje dhe gjuhë jo e dhunshme apo kërcënuese, detyrim, shfrytëzim apo frikësim;
- 6.6 Respektimi pa diskriminim i secilit person pavarësisht racën, religjionin, rrethanat personale etj;
- 6.7 Sjellje njerëzore, duke mbajtur zërin në nivel të pranueshëm e pa vrazhdësi;
- 6.8 Respekt i ndërsjellët, p.sh: bashkëpunim me stafin gjatë kryerjes së detyrave të vetë, pajtohet me pritjet e arsyeshme të stafit, pa tentime për ta gënjyer apo manipuluar stafin dhe të dënuarit e tjerë;
- 6.9 Trajtim korrekt ndaj të tjerëve, p.sh: dëshira për të ndërtuar raporte të mira me të dënuarit e tjerë dhe ofrimi i përkrahjes për ta, dhe jo ndërhyrje në pronën e huaj;
- 6.10 Qëndrimi larg nga gjërat e ndaluara p.sh. alkooli, droga apo çdo lloj kontrabande;
- 6.11 Shprehja e mendimeve, kërkesave, ankesave apo pakënaqësive në mënyrë të arsyeshme dhe konstruktive;
- 6.12 Në respekt ndaj shëndetit dhe sigurisë së të tjerëve, p.sh: pastërtia dhe rregullt i dhomave dhe hapësirave të tjera, përdorimi i duhur i pajisjeve, materialeve dhe makinave të ndryshme, sille të pajtim me procedurat e sigurisë ndaj zjarrit, përfshirë edhe rregullat për pirje duhani;
- 6.13 Shitëblerja dhe shkëmbimi i gjësëndeve mes të dënuarve është e ndaluar.

7. Me rastin e transferit (vullnetar) të të dënuarve nga një institucion në tjetrin i dënuari do të vendoset po në atë tretman që ka caktuar IK dërgues por së pari duhet ta kalojë nivelin e tretmanit të pranimit prej së paku shtatë (7) ditëve.

8. Aplikimi nga ana e të dënuarit për privilegje dhe avancim bëhet përmes formularit përkatës.

9. Për vendosjen në pavionin e tipin gjysmë të hapur nevojitet aprovimi nga Drejtori i IK.

10. Për vendosjen në institucionin apo pavionin e tipit të hapur, nevojitet rekomandimi nga Drejtori i IK dhe aprovimi nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së.

#### Neni 8

##### Ekipi Profesional i Pavijonit

1. Vendimet rreth tretmaneve adekuatë duhet të arrihen në mënyrë të drejtë dhe të puareshme dhe duhet të bazohen në sjellje e të dënuarit, krahas sjelljes, performanca në punë apo arritja e objektivave të planifikimit të dënimt duhet poashtu të merren në konsiderim.

2. Udhëheqësi i Pavijonit kujdeset për mbledhjen dhe kompletimin e raporteve para çdo shqyrtimi.

3. Ekipi profesional i pavijonit është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha raporteve të duhura për vlerësimin e situatës së të dënuarit dhe bënë propozimin për vendosjen në tretmanin përkatës.

4. Ekipi profesional përbëhet nga: zyrtari social, zyrtari korrektues, mbikëqyrësi i lartë, Udhëheqësi i pavijonit, mjeku, psikologu apo psikiatri në rast nevojë dhe zyrtari ligjor.

5. Të gjitha anekset që jepen për tu plotësuar duhet të jenë të regjistruara me numër të protokollit. Këto anekse mbahen te Udhëheqësi për Programe dhe Tretmane.

#### Neni 9

##### Ekipi Multiprofesional i Institucionit Korrektues

1. Ekipi Multiprofesional i IK përbëhet nga: Zëvendës Drejtori i IK në cilësimin e kryesuesit të ekipit, Udhëheqësi për Programe dhe Tretmane, Udhëheqësi për Siguri, Udhëheqësi i pavijonit, zyrtari social dhe sipas nevojë, zyrtari ligjor dhe Psikologu.

2. Vendimi për kalim nga një tretman në tretmanin tjetër merret me shumicë votash.

3. Nëse kryesuesi i ekipit është kundër vendosjes për kalimin në tretmanin tjetër, rasti kalon tek Drejtori i IK për vendosje.

#### Neni 10

##### Llojet e tretmaneve

1. Shërbimi Korrektues i Kosovës me qëllim të risocializimit dhe rehabilitimit të të dënuarve implementon katër (4) nivele të tretmaneve që janë:

1.1 Tretmani i Pranimit;

- 1.2 Tretmani Themelor;
- 1.3 Tretmani Standard, dhe
- 1.4 Tretmani i Avancuar.

## Neni 11

### Tretmani i pranimit

1. Në tretmanin e pranimit do të vendosen të dënuarit :
  - 1.1 Me rastin e pranimit në IK;
  - 1.2 Me rastin e transferimit nga ndonjë IK tjetër.
2. Çdo i dënuar i pranuar duhet të intervistohet sa më parë që është e mundur nga stafi kompetent për t'i vlerësuar nevojat dhe nivelin e ndjeshmërisë së tyre dhe plotësohet dokumentacioni i nevojshëm.
3. Mënyra e vendosjes të posa të pranuarit do të varet nga specifikat e cekura me lartë sipas paragrafit mbi vendosjen e të dënuarve dhe vetë kategorisë të të dënuarit në bazë të vlerësimit fillestar të sigurisë.
4. Ekipi profesional e bënë vlerësimin e të dënuarit brenda 30 dite. Ekipi multiprofesional i IK bënë shqyrtimin e raporteve dhe klasifikimin e të dënuarit në tretmanin adekuat.
5. Në parim të dënuarit pas tretmanit të pranimit kalojnë në tretman standard përpos kur sipas kushteve të caktuara dhe të cekura decizivisht kalohet në ndonjë tretman tjetër më të avancuar.
6. Për secilin të dënuar që ka dënim prej një (1) viti o tutje, menjëherë pas pranimit dhe vlerësimit të personelit të tij nga ekipi profesional i institucionit, duhet të përgatitet planifikimi i dënimit.
7. Pas pranimit, të gjithë të dënuarit do të informohen për procedurën e tretmanit të pranimit.
8. Nëse i dënuari nuk respekton rregullat e Institucionit dhe në përgjithësi tregon sjellje të keqe pas periudhës 30 ditëshe vendoset në tretman themelor.
9. Drejtori i Institucionit apo Ekipi multiprofesional autorizon vendosjen e të dënuarit nga ky tretman në tretman tjetër.

## Neni 12

### Të drejtat dhe privilegjet e të dënuarve në tretmanin e pranimit

1. Të drejtat dhe privilegjet e të dënuarve në Tretmanin e Pranimit;
  - 1.1 Vizitë familjare - 2 herë në muaj nga një orë;
  - 1.2 Katër (4) telefonata në muaj (1 telefonat në javë);
  - 1.3 Kantina në maksimum 40 € në javë;
  - 1.4 Shëtitje dy, 2 herë nga një orë gjatë ditës;
  - 1.5 Radio (nëse i dënuari e ka një të fille);
  - 1.6 TV- dy (2) orë gjatë ditës dhe një (1) orë gjatë mbrëmjes në TV-sallë (pa DVD/Video në dhomë/sallë);
  - 1.7 Aktivitetet sportive dhe rekreative brenda rrethojës së pavijonit;
  - 1.8 Punësimi mund të bëhet vetëm brenda rrethojës së pavijonit;
  - 1.9 E drejta në shtyp ditor, tekste mesimore, libra;
  - 1.10 Lojërat mbështetëse janë të lejuara (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino);
  - 1.11 Gjësende tjera të parapara me rendin shtëpijak.



## Neni 13

### Tretmani themelor

1. Ky tretman jep të drejtat minimale, sipas ligjit, standardeve dhe rregullave ndërkombëtare dhe është për ata të dënuar:
  - 1.1 Të cilët ulen nga tretmani standard për shkak të sjelljes së tyre jo të mirë;
  - 1.2 Nga tretmani i pranimit pasi kanë treguar sjellje jo të mirë;
  - 1.3 Për të dënuarit që vijnë nga tretmani i ndarjes jovullnetare;
  - 1.4 Të dënuarit të cilët vijnë pas ndëshkimit disiplinorë;
  - 1.5 Nuk dëshirojnë të punojnë apo refuzojnë punën;
  - 1.6 Për shkak të rrethanave tjera të cilat vlerësohen nga stafi kompetent
2. Të dënuarit që vendosen në këtë tretman duhet të vlerësohen brenda njëzet e tetë (28) dite dhe të informohen për hapat konkret qka pritet prej tyre për t'u kthyer në tretman standard. Kjo duhet të përfshijë objektivat konkretë që do t'u ndihmojnë atyre që të përparojnë nga tretmani themelor. Këta të dënuar përcillen përmes regjistrit ditor .
3. Të dënuarit që mbeten në këtë tretman duhet të vlerësohen së paku një herë në muaj nga ekipi vlerësues i bllokut.
4. Drejtori i Institucionit apo ekipi multiprofesional autorizon vendosjen e të dënuarit në tretman themelor.

## Neni 14

### Vazhdimi i tretmanit themelor

1. Nëse edhe pas periudhës së 28 ditëve i dënuari vazhdon sjelljen e tij destruktive (të çrregulluar) ose nuk pajtohet me rregullat përkatëse, tretmani i tij do të vazhdohet edhe për 28 ditë të tjera.
2. Pas përfundimit të kësaj periudhe ekipi profesional mund të bëjë një plan veprues për të. I dënuari do ta vazhdojë tretmanin themelor në vazhdimësi por do t'i lejohet edhe të marr pjesë në aktivitete me të tjerët. I dënuari duhet t'i ketë të qartë kufijtë e vet dhe të mësojë se si pritet nga ai një sjellje më e mirë. Gjatë periudhës së ardhshme ky rast mund të rishikohet edhe për një transferim të mundshëm për një kohë të caktuar në një IK tjetër.
3. Të drejtat e tretmanit themelor janë të njëjta me ato të tretmanit të pranimit.

## Neni 15

### Tretmani standard

1. Në tretmanin standard do të vendosen ata të dënuar që vijnë nga tretmani i pranimit apo tretmani themelor.

2. Për të kaluar nga tretmani i pranimit apo themelor në tretmanin standard personi i dënuar duhet të ketë raportin nga ekipi profesional i pavijonit me rekomandim për avansim si dhe të jetë së paku 30 ditët e fundit pa masa të shqiptuara disiplinore. Ekipi multiprofesional pas shqyrtimit të raportit do të bëjë klasifikimin e tij për në tretmanin standard .

3. Tretmani standard përfshin të gjithë ata të dënuar që:

- 1.1 Mbjajnë qetësin, pastërtinë dhe higjienën personale në nivelin e pranueshëm;
- 1.2 Marrin pjesë aktivisht në rutinën e përbashkët;
- 1.3 Respektojnë rregullat dhe rendin shtëpiak;
- 1.4 Demonstrjnë dhe shfaqin mardhënje të mira dhe të shëndosha me stafin dhe të dënuarit e tjerë;
- 1.5 Marrin pjesë në punë (nëse është e mundur);
- 1.6 Marrin pjesë në planifikim dënimi;
- 1.7 Qëndrojnë larg nga gjërat e ndaluara p.sh. alkooli, droga apo çdo lloj kontrabande.

4. Të dënuarit në tretmanin standard mund të aplikojnë që të ngriten në tretmanin e avancuar pas tre (3) muajve, dhe pas kësaj në çdo tre muaj.

5. Të dënuarit që nuk aplikojnë për avancim dhe gjithë ata që ngriten në tretmanin avancuar duhet të vlerësohen për çdo vit për t'u siguruar se sjellja e tyre reflekton nivelin e shfrytëzimit të privilegjeve.

## Neni 16

### Të drejtat dhe privilegjet në tretmanin standard

1. Të drejtat dhe Privilegjet në Tretmanin janë:

- 1.1 Vizitë Familjare - 2 herë nga një orë në muaj, plus 1 ekstra vizitë një orëshe, brenda tre muajve, me aprovim të Drejtorit të IK apo të deleguarit të tij;
- 1.2 Katër (4) telefonata në muaj (1 telefonat në javë);
- 1.3 Kantina 40 € në javë;
- 1.4 Dy shëtitje nga 1 orë në ditë;
- 1.5 TV në dhomë, radio, pajisje shtesë për dëgjimin e muzikës pa mundësi incizimi;
- 1.6 Aktivitete sportive edhe në sallë dhe fusha sportive;
- 1.7 Punësim brenda dhe jashtë pavijonit;
- 1.8 E drejta në shtyp ditor, tekste mësimore, libra;
- 1.9 E drejta në edukim dhe trajnime profesionale;
- 1.10 Llojra mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, tetra, domino);
- 1.11 Vizitat në lokale të veçanta, 1 herë në 3 muaj;
- 1.12 Gjësente tjera të parapara me rendin shtëpiak.

## Neni 17

### Tretmani i avansuar

1. Të dënuarit sjellja e të cilëve është vazhdimisht në standard të lartë dhe të cilët respektojnë rendin shtëpiak dhe rregullat e IK, mund të kalojnë në tretmanin e avansuar.



2. Për të kaluar nga tretmani standard në tretmanin e avansuar personi i dënuar duhet të ketë raportin nga ekipi multiprofesional për avansim.
3. Kriteret që kërkohen për të kaluar në këtë tretman janë:
  - 1.1 Të ketë dënimin e plotëfuqishëm;
  - 1.2 Të respektojë rendin shtëpiak dhe rregullat e IK;
  - 1.3 Të demonstrojë mardhënie të mira me stafin dhe të dënuarit e tjerë;
  - 1.4 Tregojë gatishmëri për punë;
  - 1.5 Të përmbahet planifikimit të dënimin;
  - 1.6 Të mos i jetë shqiptuar ndonjë dënim disiplinor brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit;
  - 1.7 Të mos kenë qenë i pushuar nga puna brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit me fajin e tij;
  - 1.8 Në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë i përfshirë në ndonjë protest apo të refuzoj urdhrat e stafit.
4. Personat e dënuar, të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme, do të kalojnë nëpër procedurë të shkurtër (7 deri në 30 ditë tretman pranimi) që të kalojnë në tretman të avansuar nëse:
  - 1.1 vijnë vullnetar në vargje të dënimin;
  - 1.2 dënimin të jetë i plotëfuqishëm dhe nuk i kalon 3 vite;
  - 1.3 nuk është reaktivist;
  - 1.4 niveli i rrezikshmërisë është i ulët.
5. Gjithashtu i dënuari mund të vendoset në tretmanin e avansuar me rastin e ardhjes nga ndonjë IK tjetër që ka qenë në tretmanin e avansuar, pas vlerësimit nga ekipi multiprofesional i IK.
6. Pava se të bëhet shqyrtimi kryesor për tretmanin e avansuar raportet kompletohen nga ekipi profesional i pavionit, në mënyrë që ekipa multiprofesionale e IK të jetë e gatshme për të bërë klasifikimin e duhur.

## Neni 18

### Të drejtat dhe privilegjet në tretmanin e avansuar

1. Të drejtat dhe privilegjet në tretmanin e avansuar janë:
  - 1.1 Vizitë familjare - 2 herë nga një orë në muaj plus 1 ekstra vizite një orëshe, brenda një muaji, me aprovim të Drejtorit të IK apo të deleguarit të tij;
  - 1.2 Tetë (8) telefonata në muaj (2 telefonata në javë);
  - 1.3 Kantina 60 C në javë;
  - 1.4 Dy shëtitje nga 1 orë në ditë;
  - 1.5 TV në dhomë me DVD/Video, pajisje shtesë për dëgjimin e muzikës pa mundësi incizimi.
  - 1.6 Aktivitetet sportive në sallë dhe fusha sportive;
  - 1.7 Mundësi që të punojë jashtë perimetrit të banimit nën mbikqyrje;
  - 1.8 Të drejta në shtyp ditor, tekste mësimore, libra;
  - 1.9 Të drejta në edukim dhe trajnime profesionale;
  - 1.10 Lojra mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino);
  - 1.11 Mundësi në vizita në lokale të veçanta, dy herë në tre muaj (për ata që nuk shfrytëzojnë pushimin jashtë IK);
  - 1.12 Mundësi për pushim jashtë IK;
  - 1.13 Çfjësente tjera të parapara me rendin shtëpiak.

## Neni 19

### Tretmani në tipin gjysëm të hapur

1. Të dënuarit të cilët janë të pranueshëm për t'u vendosur në Tipin Gjysëm të Hapur janë të dënuarit e tretmanit të avansuar.
2. Brenda institucionit Korrektues, të dënuarit mund të vendosen në njësi gjysmë të hapura, gjithashtu edhe në Institucionin Korrektues të tipit të mbyllur në të cilin aplikohet tipi gjysmë i hapur.
3. Kriteret për kalim në tipin gjysëm të hapur janë:
  - 1.1 Të ketë dënimin e plotëfuqishëm;
  - 1.2 Të mos ketë vepra tjera penale në pritje;
  - 1.3 Të mos ketë ndëshkime disiplinore gjatë periudhës së kaluar gjatë (6) mujore;
  - 1.4 Të jetë në gjendje të mirë mentale dhe fizike;
  - 1.5 Të jetë çdo herë i gatshëm për punë;
  - 1.6 Të marr pjesë në planifikim dënim;
  - 1.7 Pjesa e mbetur e dënimit të tyre të mos kaloj 4 (katër) vite;
  - 1.8 Të respektojë rendin shtëpiak dhe rregullat e IK;
  - 1.9 Të demonstrojë marrëdhënie të mira me stafin dhe të dënuarit e tjerë.
4. Përjashtimisht pikës 1.7 të këtij neni të dënuarit me dënim më të gjatë se katër (4) vite, të cilët janë shfrytëzues të rregullt të pushimit jashtë IK mund të kalojnë në tipin gjysëm të hapur nëse kanë shfrytëzuar rregullisht të paktën tre (3) vikende dhe nuk kanë asnjë masë disiplinore gjatë mbajtjes së dënimit.
5. Të dënuarit të cilët vijnë vullnetar në vuajtje të dënimit, dhe dënimin e tyre nuk kalon 1 vit, ose mbetja e dënimit të tyre nuk kalon 1 vit, mund të kalojnë në procedurë të shpejtuar pasi që të jetë bërë vlerësimi i tyre nga ekipi multiprofesional i IK pas 7 dite nga data e pranimit.
6. Llogaritja e dënimit do të bëhet sipas lirimit normal të dënimit.
7. Për vendosje në tipin gjysmë të hapur nevojitet aprovimi i Drejtorit të Institucionit Korrektues.
8. Vlerësimi për tu vendosur në tipin gjysmë të hapur bëhet nga ekipi multidisiplinar i IK përmes formularit përkatës.

## Neni 20

### Të drejtat dhe privilegjet në tipin gjysëm të hapur

1. Të drejtat dhe Privilegjet në tipin gjysmë të hapur janë:
  - 1.1 Vizitë familjare - 4 herë nga një orë në muaj (një vizitë në javë);
  - 1.2 Telefonatat e pakufizuara (sipas orarit të caktuar);
  - 1.3 Kantina 60 € në javë;
  - 1.4 Dy shëtitje nga 1 orë në ditë;
  - 1.5 TV në dhomë me DVD/Video, Radio, pajisje shtesë për dëgjimin e muzikës pu mundësi inçizimi;

- 1.6 Aktivitetet sportive në sallë dhe fusha sportive sipas orarit të përcaktuar në rendin shtëpiak;
- 1.7 Mundësi që të punojë jashtë perimetrit të IK pa mbikëqyrje;
- 1.8 Të drejta në shtyp ditor, tekste mesimore, libra;
- 1.9 Të drejta në edukim dhe trajnime profesionale;
- 1.10 Llojra mbështetëse (shah, ujëri mos u hidhëro, letra, domino);
- 1.11 Mundësi për pushim jashtë IK;
- 1.12 Të drejtat tjera të përcaktuara me rendin shtëpiak.

## Neni 21

### Tretmani i hapur

1. Të dënuarët, që punojnë apo marrin pjesë në aktivitete tjera rehabilituese, të cilët janë të vlerësuar se janë të adaptueshëm kushteve pa kufizim të IK të hapura, dhe të cilët supozohen se nuk do ta lëshojnë institucionin pa leje mund të vendosen në Institucionin Korrektues të tipit të hapur.
2. Brenda Institucionit Korrektues, në të cilat aplikohet tretmani i hapur të dënuarët mund të vendosen në njësi të hapur.
3. Në institucionin e tipit të hapur apo në njësien e tipit të hapur brenda Institucioneve mund të vendosen të dënuarët që kanë dënim deri në 3 vite ose që mbetja e dënimt nuk i kalon 3 vite.
4. Përcjashimisht paragrafi 3 të këtij neni të dënuarët me dënim më të gjatë se tre (3) vite mund të vendosen në IK të tipit të hapur nëse plotësojnë kriteret në vijim:
  - 1.1 Sjellja e tyre është cilësuar shumë e mirë, në nivelin më të lartë;
  - 1.2 Marrin pjesë aktivisht në programet e parapara për ta;
  - 1.3 Janë shfrytëzues të rregullt të pushimit në shtëpi, së paku tre (3) vikende;
  - 1.4 Të mos kenë asnjë masë disiplinore gjatë mbajtjes së dënimt;
  - 1.5 Respektojnë plotësisht rregullat e institucionit;
  - 1.6 Vlerësimi i ulët i rrezikshmërisë nga ekipi multiprofesional i IK.
5. Para se të dërgohet i dënuari në njësi të hapur i bëhet një vlerësim i rrezikshmërisë nga ekipi multiprofesional i IK se a është i përshtatshëm për atë tretman. Interes i veçantë i kushtohet rrezikshmërisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe a paraqet rrezik për arratisje.
6. Vendimi përfundimtar për transferimin e të dënuarit në tipin e hapur e merr Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së me rekomandim të Drejtorit të IK.
7. Tretmani i hapur bazohet në plotësimin e kriterëve dhe në besim. Ç'fardo shkelje të kriterëve apo thyerje të besimit do të iniciohet procedurë disiplinore.
8. Të dënuarët të cilët pranohen drejtpërdrejt në IK të tipit të hapur së pari duhet të vendosen në pavionin e pranimit deri në vlerësimin dhe rekomandimin nga ekipi multidisiplinar.



## Neni 22

### Të drejtat dhe privilegjet në tretmanin e tipit të hapur

1. Të drejtat dhe Privilegjet në Tretmanin në Tipit e Hapur janë:
  - 1.1 Vizita të pambikqyrtura - 8 herë në muaj nga një orë;
  - 1.2 Telefonatat e pakufizuara sipas orarit të përcaktuar;
  - 1.3 Kantina 70 C në javë;
  - 1.4 Dy shëtitje nga 1 orë në ditë;
  - 1.5 TV në dhomë me DVD/Video, pajisje shtese për dëgjimin e muzikës pa mundësi inqizimi;
  - 1.6 Aktivitetet sportive në sallë dhe fusha sportive;
  - 1.7 Mundësi që të punojë jashtë perimetrit të IK pa mbikqyrje;
  - 1.8 E drejta në shtyp ditor, tekste mësimore, libra;
  - 1.9 E drejta në edukim dhe trajnime profesionale;
  - 1.10 E drejta në komunikim elektronik (Skype);
  - 1.11 Loja mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domluo);
  - 1.12 Mundësi për pushim jashtë IK ;
  - 1.13 Mundësi të punësimit jashtë IK;
  - 1.14 Mund të përgadisim vetë ushqimin;
  - 1.15 Mund t'i veshin rrobat e veta personale.
  - 1.16 Gjësende tjera të parapara me rendin shtëpiak

## Neni 23

### Tretmanet specifike

1. Tretmani për të dënuarit me Rrezikshmëri të Lartë dhe Shumë të Lartë e kategorizuar sipas Rrezikshmërisë nga KKB-ja.
2. Për këto kategori të të dënuarve duhet aplikuar, aq sa është e mundshme, rregulla të zakonshme të IK por me masa të shtuara të sigurisë.
3. Të aplikohen masa të sigurimit vetëm në atë masë sa patjetër kërkohen.
4. Të aplikohen masat e sigurisë në atë mënyrë që respekton të drejtat dhe dinjitetin njerëzor.
5. Të dënuarit me rrezikshmëri të lartë duhet të vendosen në dhomë të Ssipas rregullave përkatëse për kategorizim, përpos nëse Drejtori i Institucionit jep tjetër autorizim me shkëmbim.
6. Të dënuarit me rrezikshmëri të lartë kategori kanë të drejtë në edukim, trajnime profesionale, punë, dhe aktivitete rekreative aq sa lejojnë kushtet e sigurisë brenda njesis se veqant.
7. Këta të dënuar kanë të drejtë për gjësende të njëjta personale si të dënuarit që nuk i takojnë kësaj kategorie përpos nëse janë duke vuajtur ndonjë dënim disiplinor.
8. Komunikimi përmes telefonatave monitorohet.
9. Të gjithë të dënuarve duhet t'u bëhet vlerësimi i sigurisë brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit. Nëse gjatë këtij vlerësimi hasen elemente se i dënuari mund t'i takoj rrezikshmërisë së lartë, Drejtori i Institucionit duhet të përcjell rastin tek Komisioni për Kategorizimin e të Dënuarve në DQ të SHKK-së. Rivlerësimi duhet të bëhet çdo 28 ditë në Institucion dhe çdo 6 muaj në DQ të SHKK-së. Sistemi i shyrtimeve të rregullta kohore siguron që koha e kaluar në kushte të përfortuara siguruese të IK dhe niveli i sigurisë që aplikohet të mos kalojë aq sa kërkohet.

10. Privilegjet t'u takojnë sipas kategorisë dhe tretmanit themelor që i përkasin sipas Rregullores Menaxhimi i te Burgosurve me kategori.

11. Sipas vendimit të Drejtorit, këtyre të dënuarve mund t'u hiqen kulizimet gjatë vizitave.

## Neni 24

### Tretmani i ndarjes së të dënuarve

1. Tretmimi i ndarjes së të dënuarit.

2. Me kërkesë të personit të dënuar, Drejtori i Institucionit Korrektues mund të lejojë që personi i dënuar të ndahet nga personat tjerë të dënuar në një njësi të veçantë të Institucionit Korrektues dhe nëse drejtori konstaton se shqetësimet e paraqitura në kërkesën e personit të dënuar janë të arsyeshme dhe nuk ka mundësi të tjera për zgjidhjen e tyre.

3. Drejtori i Institucionit Korrektues mund të urdhërojë që personi i dënuar të ndahet nga personat e tjerë të dënuar edhe pa kërkesën e personit të dënuar vetëm kur kjo masë është e nevojshme:

3.1 Për t'u shmangur rrezikut për jetën ose shëndetin e personit të dënuar ose të personave tjerë;

3.2 Për t'u shmangur rrezikut të sigurisë në institucion korrektues të shkaktuar nga pranja e vazhdueshme e personit të dënuar në mesin e të dënuarëve e personave të tjerë të IK;

3.3 Për të siguruar integritetin e hetimit të ndonjë qështjeje disiplinore.

4. Ndarja nuk mund të lejohet për një periudhë që i kalon 30 ditë. Vendimi i tillë rishikohet për aq sa ka nevojë, por të paktën një herë në 10 ditë.

5. Kur ndarja është urdhëruar për parandalimin e personit të dënuar për të mos ndikuar në personin tjetër të dënuar në shkëlqen e rëndë të reaudit brenda Institucionit Korrektues ose për parandalimin e tij në kryerjen e aktivitetit të vazhdueshëm kriminal në Institucionin Korrektues, personi i dënuar mund të vendoset në njësi të veçantë të Institucionit Korrektues kur pritet që ndarja të zgjasë shumë.

6. Drejtori i Institucionit mund të urdhërojë ndarjen e personit të dënuar i cili silltet në mënyrë të dhunshme nga personat tjerë të dënuar pa kërkesën e tij për aq sa është e nevojshme të pengoj sjelljen e tij të dhunshme.

7. Formulari i përcjelljes ditore të të dënuarit bëhet për secilin të dënuar i cili është ndarë me kërkesën apo pa kërkesën e tij.

8. Personeli i kualifikuar shëndetësor e kontrollon personin e dënuar të ndarë së paku një herë në ditë dhe sipas nevojës.

9. Vendimi për ndarjen e personit të dënuar nga personat tjerë të dënuar ndërpritet posa të pushojë së ekzistuari arsyet për urdhrin e ndarjes , ose në raste kur personeli i kualifikuar

shëndetësor konstaton se vazhdimi i ndarjes do të jetë i dëmshëm për shëndetin e personit të dënuar.

10. Personit të dënuar të ndarë prej personave tjerë të dënuar i njihen të njëjtat të drejta , beneficione dhe kushte sikurse ato të cilat i gëzojnë të gjithë të dënuarit tjerë përveç atyre beneficioneve të cilat mund të gëzohen vetëm bashkërisht me të dënuarit tjerë apo të cilat nuk mund të sigurohen për shkak të kufizimeve që i kanë njësitë e Institucionit Korrektues në të cilin është i vendosur personi i dënuar i ndarë.

11. Të gjithë të dënuarit e ndarë vazhdojnë të kenë të drejtë të vizitohen nga mbrojtësi i aprovuar i tyre, kryetari i Qjykatës Kompetente (ose i deleguari i tij), Ombuspersoni dhe të gjitha organizatat tjera monitoruese të lejuara.

12. Të dënuarve të ndarë privilegjet iu takojnë sipas tretmanit nga i cili kanë ardhur dhe pas përfundimit të ndarjes kthehen në tretmanin në të cilin ishin para ndarjes, përveç nëse kanë treguar sjellje negative gjatë tretmanit të ndarjes. Në këtë rast të dënuarit kthehen në një tretman më të ulët. Përndryshe ata mund të marrin pjesë në aktivitete nëse vlerësohet se nuk paraqesin rrezik për personat e dënuar të tjerë dhe sigurinë e përgjithshme të aktivitetëve tjera të Institucionit.

13. Menaxhmenti i Institucionit duhet të sigurojë që të dënuarve të ndarë, t'i jepet mundësia që të angazhohen në edukim, trajnime profesionale dhe në punë.

14. Vizitat e të dënuarve të ndarë me kërkesë duhet të jenë të hapura sipas tretmanit të cilit i kanë takuar më parë.

15. Personit e ndarë kanë të drejtë të mbajnë një kopje të vendimit për ndarje.

## Neu 25

### Tretmani i vetmisë

1. Dënim i disiplinor i vetmisë konsiston në mbajtjen e vazhdueshme të personit të dënuar në dhomë të veçantë.

2. Dhoma për ekzekutimin e vetmisë ka një hapësirë prej së paku dhjetë (10) metra kub, pajisje sanitare, dritë natyrale, ujë të pijshëm, shtrat me qarshaf, tavolinë, karrige dhe ngrohje.

3. Vetmia shqiptohet vetëm për shkelje të rënda disiplinore, dhe nuk mund të zgjatë më tepër se 15 ditë.

4. Në rastin e shqiptimit të dënimit disiplinor të vetëm për shkelje disiplinore në bushkëm, vetmia nuk është më e gjatë se 30 ditë.

5. Periudha e përgjithshme e vetmisë nuk mund të jetë më e gjatë se 2 muaj gjatë një viti kalendarik.



6. I dënuari kontrollon nga mjeku para se t'i ekzekutohet dënimi disiplinor i vetmisë. Mjeku përmes raportit me shkrim konstaton se i dënuari është në gjendje të aftë psiko fizike për mbajtjen e vetmisë.

7. Gjatë ekzekutimit të vetmisë personi i dënuar i gëzon të njëjtat kushte higjienike dhe shëndetsore si të dënuarve tjerë.

8. Ushqimi do t'iu servohet në dhomë.

9. I lejohet qëndrimi jashtë ambientit të mbyllur së paku dy (2) ( 1 ) orë në ditë për ajër të pastër dhe për ushtrimë ( ne shetitore te veqant).

10. Ka te drejtë në vizitë familjare një herë nga një (1) orë ( 30 min. ), gjatë 15 ditëve,

11. Ka të drejtë në shtyp ditor, tekste mësimore, libra.

12. Se çfarë gjësesh tjera do t'iu lejohet personave në vetmi varet nga vendimi i Drejtorit të Institucionit i cili bazohet në bazë të rrezikshmërisë së tyre qoftë ndaj vetes, pronës së Institucionit ose ndaj të tjerëve.

13. Sjellja e tyre vëzhgohet çdo ditë dhe plotësohet formulari përkatës i përcjelljes ditore .

14. Personi në vetmi vizitohet nga mjeku çdo ditë, drejtori dhe zyrtari social e vizitojnë një herë në 7 ditë ose kur e kërkon nevoja edhe më shpesh.

15. Pas kryerjes së vetmisë i dënuari do të kthehet në tretman themelor.

## Neni 26

### Tretmani për femrat shtatzënë dhe ato me fëmijë

1. Gratë shtatzëna, gratë që lindin fëmijë dhe nënat që përkujdesen për fëmijët e tyre vendosen ndarazi nga gratë tjera të dënuara.

2. Femrat shtatzënë dhe ato me fëmijë pranohen në tretman pranimit por me privilegje të tretmanit standard. Tretmani i JK duhet te jetë fleksibil njustueshëm qe t'iu pergjigjet nevojave të tyre. Kujdes i veqantë duhet të ekzistojë në institucione me qëllim që t'iu mundësojë atyre pjesëmarrje në aktivitetet e JK dhe programe adekuatë.

3. Femrat e dënuara të afta për punë kanë të drejtë pune si brenda ashtu edhe jashtë Institucionit Korrektues.

4. Femrat shtatzënë kanë të drejtë të mos punojnë për shkak të shtatzanisë, lindjes dhe amësisë, në pajtim me dispozitat e përgjithshme të punës në Institucion Kkorrektues.

5. Femrave duhet ofruar programe të dhura dhe shërbime që t'iu plotësojë nevojat e tyre fizike, sociale dhe psikologjike.

6. Grupet e veçanta të femrave, femrat e mitura, femrat me aftësi të kufizuara, femrat me nacionalitetet të huaj dhe të tjera minoriteteve, kanë edhe më tepër nevoja të veçanta si femra.
7. Kur fëmija të mbahet në Institucione Kkorrektuese me nënën e tij, do të merren masa të posaçme për sigurimin e një dhome fëmijësh.
8. Dhoma për vizita me fëmijë duhet të jetë me një ambient shumë të përshtatshëm për fëmijë (pa prezencën e oficerëve korrektues), i shndërrueshëm me ngjyra me hapësirë të njafueshme për lojra të fëmijëve dhe ulëse komode. Të gjitha vizitat në pavijonet e femrave janë "vizita kontakti", që do të thotë aty nuk ka kufizime sa i përket përfaqimeve, ulje në prehër, mbajtje në kraharor etj.
9. Vizitat që përshijnë kontakt me të zgjator me fëmijët duhet inkurajuar, sa herë që ka mundësi.
10. Vizitat nga familjarët lejohen së paku 8 herë në muaj.
11. Për vizitat që u bëhen nënave të dënua nga fëmijet e tyre do të zbatohen rregulla të veçanta institucionale që atyre tu mundësojnë vizita më të rregullta.
12. Femrat e dënua kanë të drejtë vizite në lokale të veçanta sikur edhe të dënuarit meshkuj.
13. Gratë shtatëzëna kërkojnë një vëmendje të veçantë sa i përket dietës, veshjeve, barnave, dhe përkujdesjes shëndetësore. Ato kanë nevojë për larje më të shpeshta dhe tush.
14. Dënimi me vetmi apo ndajje pa kërkesën e vet nuk duhet të aplikohet ndaj femrave shtatëzëne dhe atyre me fëmijë.
15. Dënimet disiplinore për femrat e dënua në përgjithësi nuk duhet të përfshijnë ndallimin e kontakteve familjare, veqanërisht me fëmijët.

## Neni 27

### Mbahatja e fëmijës nga ana e femrës së dënuar

1. Femra e dënuar që ka fëmijë mund ta mbajë atë derisa i mbush tetëmbëdhjetë (18) muaj dhe pastaj prindërit e fëmijës vendosin, nëse kujdestaria e fëmijës i besohet babait, të atërve, ose personave të tjerë.
2. Nëse prindërit nuk pajtohen për kujdestarinë e fëmijës, ose nëse marrëveshja e tyre është e dëmshme për fëmijën, gjykata e cila është kompetente sipas vendbanimit, ose vendqëndrimin të nënës në kohën kur është dënuar ajo vendos se kujt i besohet fëmija.
3. Kur sipas paragrafit 2. të këtij neni merret vendim, gjykata para së gjithash merr parasysh interesin më të mirë të fëmijës, duke përfshirë mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijës, si dhe mirëqenien e tij fizike dhe shpirtërore.
4. Kur fëmija mbahet në institucionin korrektues me nënën e tij merren masa të posaçme për sigurimin e një dhome fëmijësh me persona të kualifikuar në të cilën vendoset fëmija kur nuk është nën kujdesin e nënës së tij.

## Neni 28

### Tretmani për dëshmitarët e mbrojtur

Tretmani për dëshmitarët e mbrojtur bëhet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara për këtë kategori.

## Neni 29

### Tretmani për të paraburgosurit

Tretmani për të paraburgosurit zbatohet përshatshëmrisht me tretmanët e të dënuarve deri në nivelin e lejuar si dhe me udhëzimin administrativ për rendin shtëpiak.

## Neni 30

### Tretmani për të miturit

Tretmanet për të miturit zbatohen sipas akteve nënligjore për të Mitur.

## Neni 31

### Aktivitetet e tretmaneve

1. Aktivitetet e tretmaneve mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:
  - 1.1 Shkollimin;
  - 1.2 Trajnimet profesionale;
  - 1.3 Punën dhe terapitë okupuese;
  - 1.4 Shkathësitë sociale dhe trajnimet kompetente;
  - 1.5 Menagjimi i agresivitetit;
  - 1.6 Terapië për varësi;
  - 1.7 Terapië individuale dhe grupore;
  - 1.8 Edukimi fizik dhe sporti;
  - 1.9 Edukimi terelar dhe vazhdues;
  - 1.10 Programet për drejtësi restorative dhe bërja e riparimeve për shkak të veprës;
  - 1.11 Aktivitetet e lira kreative dhe hobitë;
  - 1.12 Aktivitetet jashtë institucionit në komunitet, pushimet ditore dhe format tjera të pushimit;
  - 1.13 Përgatitja për lirim dhe i përkujdesjes së pas lirim.
2. Tretmanet dhe programet janë të ndërlidhura dhe mbështesin njëra tjetrën.
3. Këto aktivitete duhet të përpiqen të plotësojnë nevojat individuale të të dënuarve në pajtim me moshën e tyre, gjininë, prejardhjen sociale dhe kulturore, shkallën e zhvillimit dhe llojin e veprës së kryer.
4. Të dënuarit do të vendosen vetëm në ato programe të cilat ju përshatzen pas konsultimeve të duhura me Zyrtarin Social i cili pastaj rekomandon për kërkesën e tij tek ekipi profesional i planifikimit të dënimit. Ekipi profesional në bazë të raportit të zyrtarit social vendosë për rrjedhën e mëtuajshme të zhvillimit të procedurës.
5. Institucioni duhet poushtu të japë aktivitete kuptimplota edhe gjatë vikendeve dhe pushimeve.



6. Qëllimi i të gjitha programeve duhet të jetë riintegrimi i suksesshëm i personave të dënuar në shoqëri. Për të ndihmuar në këtë, pjesëmarrja e institucioneve publike dhe private duhet të inkurajohet. Grupet do të inkurajohen të ndihmojnë të dënuarit në rehabilitimin e tyre posaqërisht lidhur me familjen dhe punësimin.

7. Programet janë më të suksesshme kur ka të bëjë me nivelin e lartë të bashkëpunimit në mes stafit dhe të dënuarve. Lidhur më këtë duhet të inkurajohet siguria dinamike.

### Neni 32

#### Shkollimi

1. Edukimi në Institucion Korrektues ka për qëllim ta zhvillojë personin duke marrë parasysh kontekstin e tij/saj social, ekonomik dhe kulturor.

2. Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, përderisa për personat e dënuar analfabet organizohen kurse të posaqme. Përmes programeve të veçanta Drejtori i Institucionit Korrektues i mundëson personit të dënuar vijimin e shkollimit imverzitar apo ndonjë shkollim tjetër. Shpenzimet e shkollimit të tillë i mbulon personi i dënuar.

3. Trajnimet profesionale duhet të kenë për qëllim një zhvillim më të gjerë të individit, e poashtu të jenë të vëmendshme për drejtimit që ekzistojnë në tregun e punës.

4. Edukimi s' duhet të ketë status më të ulët se puna përbrenda tretmanit të IK dhe të dënuarit nuk duhet të jenë në situatë të pafavorshme financiarisht apo në mënyrë tjetër nëse marrin pjesë në edukim.

### Neni 33

#### Puna

1. Puna në IK duhet të konsiderohet si element pozitiv i tretmanit të Institucionit Korrektues dhe kurrë nuk duhet të përdoret si formë e dënimit disiplinor.

2. Institucioni nëse është e mundur duhet të siguroj punë personit të dënuar.

3. Puna e personit të dënuar duhet të shpërblehet.

4. Kur të dënuarit marrin pjesë në aktivitetet gjatë orarit të punës ata duhet shpërblyer në të njëjtën mënyrë sikur të kishin punuar.

5. Të dënuarit duhet të marrin sigurim adekuat social ngjashëm me atë që jepet në shoqërinë e lirë.

6. Nga i mitori nuk pritet dhe as nuk kërkohet të punojë gjatë kohës sa është në shkollë.

7. Femrat kanë të drejtë të mos punojnë gjatë shtatzanisë, lehonisë ose për shkak të lindjes në pajtim me parimet e punës.

#### Neni 34

##### Kontakti me hofën e jashtme

1. Të dënuarit duhet lejuar të komunikojnë përmes letrave, pa kufizim sa i përket numrit të tyre dhe sa më shpesh që është e mundur përmes telefonit apo formave tjera të komunikimit me familjet e tyre.
2. Të dënuarit e huaj, të cilëve familja dhe shokët janë jashtë këtij shteti, pritet që të kenë mundësi ekstra dhe më me mundësi fleksibile për të bërë telefonata se sa të pranojnë vizita.
3. Komunikimi dhe vizitat mund të jenë subjekt kufizimi dhe monitorimi kur është e nevojshme për çështje sigurie por çdo herë duhet të lejohet një minimum i pranueshëm i kontaktit.

#### Neni 35

##### Aktivitetet religjioze

1. Tretmani i IK duhet të organizohet për aq sa është e mundur të dënuarit ta ushtrojnë praktikimin e religjionit të tyre, të marrin pjesë në shërbimet religjioze, takimet e lutjeve dhe ngjarjet tjera religjioze të udhëhequra nga përfaqësuesit e tyre të aprovuar të atij religjioni apo besimi, të pranojnë vizita private nga përfaqësuesit e fillë dhe të kenë në posedim të tyre libra apo literaturë në lidhje me religjionin apo besimin e tyre.

#### Neni 36

##### Llojet e terapisë

1. **Terapia okupuese** - Ka për qëllim t'u ndihmojë të dënuarve që të rrisë pavarësinë e tyre funksionale gjatë jetës së përditshme përdërisa parandalon apo minimizon pasqesinë që sjell Institucioni nga ana e vet.
2. **Terapia individuale dhe grupore** - Ka për qëllim zhvillimin e të dënuarve në aspektin emocional, social, edukues dhe për zgjidhjen e problemeve personale.
3. **Edukimi fizik dhe sporti** - Sporti dhe aktivitetet rekreative i'u mundësohen të dënuarve që të ndihmojë në uljen e stresit dhe dhunës përbrenda Institucionit. Këto aktivitete janë të dizajnuara që të promovojnë në mënyrë të jetës së shëndoshë dhe me qëllim të uljes së shpenzimeve mjeksore. Të inkurajojë shkathtësi pozitive sociale, institucionet korrektuese ofrojnë sporte në grupe përdërisa sportet me ushtrime ofrojnë qëllimin që i dënuari të zhvillojë një imazh pozitiv për vetveten.
4. **Aktivitetet e lira kreative dhe hobit** - Këto aktivitete duhet të ipen në të gjitha Institucionet për mirëqenjen fizike dhe mentale të të dënuarëve. Aktivitetet kulturore dhe kreative kanë rol të madh dhe potencial që i'u mundëson të dënuarve ta zhvillojnë dhe shprehin vetveten.
5. **Llojrat dirigjuese** - Nëse llojrat dirigjuese janë të lejueshme si privilegj shtesë, ato nuk duhet dhënë nga shpenzimet publike dhe vetëm për të dënuarit në tretman të avancuar. Disa llojra janë me mundësi efi-fi, e kjo është, se ato mund të përdoren për qasje në internet që nuk ka mbrojtje



Regulla e thjeshtë është se as një lojë dirigjuese me mundësi të-lic nuk duhet të lejohet në IK.

6. Aktivitetet jashtë Institucionit në komunitet, pushimet ditore dhe format tjera të pushimit Këto aktivitete dhe beneficione mund t'i ripërtëjnë marrëdhënjet familjare dhe shoqërore e që do t'u mundësojë atyre që të përshtaten më lehtë kur të lirohen në komunitet. Involvimi i të dënuarëve në këto aktivitete të jashtme është çdo herë i bazuar në sajë të vlerësimit të trezikshmërisë së personit të dënuar.

7. Përgaditja për lirim dhe përkujdesja pas lirimit - Qëllimi primar i programeve paraliruese është përgaditja e të dënuarëve për një reintegrim të suksesshëm në shoqëri me lirin e tyre. Aktivitetet dhe shërbimet e Institucionit janë të dizajnuara që të përmirsojnë qëshfjen e punësimit të të dënuarëve, shkathtësitë e raporteve sociale dhe njerëzore me qëllim që të implementohet një reintegrim i suksesshëm në bashkëpunim me institucionet relevante si dhe agjensionet e jashtme.

### Neni 37

#### Ullja (degradimi) nga tretmani

1. Dënim i disiplinor është në proporcion me shkëlqjen disiplinore të kryer nga personi i dënuar. Personi i dënuar nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtën vepër
2. Ullja e tretmanit nuk konsiderohet dënim disiplinor.
3. Nëse sjellja e të dënuarit apo mungesa e progresit tregon se ai nuk mund ta mbajë nivelin e vet momental të tretmanit, ai mund të degradohet në një nivel më poshtë (si masë administrative, jo si dënim i shqiptuar me vendim). Një degradim i madh i të dënuarit si p.sh nga i avancuari në themelor duhet shmangur përpos në rastet më të rënda të këqsjelljes si p.sh; rrahja etj. Në këto raste vendimet i merr Drejtori i Institucionit.
4. Sistemi disiplinor dhe ai i tretmaneve-përfitim të privilegjeve janë dy sisteme të ndara. Nivelet e tretmaneve determinohen në bazë të sjelljes. Procesi disiplinor ndihmon në mbajtjen e rëndit dhe disiplinës përbrenda IK duke shpërthyer dënimet për incidente specifike. Mund të ketë raste kur sjellja rezultojë si me shanca disiplinore për veprim specifik dhe pashtu në shqyrtimin e nivelit të tretmaneve sepse sjellja e të dënuarit bie poshtë standardeve të kërkuara.
5. Humbja e privilegjit të caktuar si pasojë e dënimit disiplinor, apo që është në dikrecion të Drejtorit të Institucionit nuk duhet të rezultojë automatikisht në humbjen e tretmanit.
6. Çdo herë kur i dënuari nuk i respekton rregullat e Institucionit dhe të tretmanit në të cilin gjendet, oficeri korrektues, i cili përcjell të dënuarin, ka për obligim të njoftojë mbikëqyrësin e lartë. Mbikëqyrësi i lartë ka për obligim të bisedojë me të dënuarin me qëllim të këshillimit dhe të njoftojë se do të jetë nën përcjellje për dhjetë (10) ditë e mëshme për t'u përmirësuar sjelljen dhe performancën. Për sjelljen e të dënuarit në baza ditore njoftohet edhe Udhëheqësi i bllokut.
7. Degradimi nga tretmani standard në tretmanin themelor parasheh disa hapa që duhet ndërmarrë:
  - 7.1 Nëse i dënuari dështon në përmbushjen e kritereve të percaktuara në tretmanin standard;
  - 7.2 Tri vërejtje me shkrim brenda periudhës tre mujore;
  - 7.3 Shpallet fajtor për shkelje disiplinore;
  - 7.4 Refuzon të punoj apo të marr pjesë aktive në planin e planifikimit të dënimt.



8. Degradimi nga tretmani i avancuar në atë standard. Personi i dënuar do të ulet në tretman standard nëse;
- 8.1 Gjendet fajtor në ndonjë shkelje disiplinore;
- 8.2 Dështimi i përmbushjes së kriterëve të tretmanit të avancuar;
- 8.3 Refuzon të punoj apo të marr pjesë aktive në planin e planifikimit të dënimit;
- 8.4 Me këtë rast bëhet propozimi për uljen e tretmanit. Ekipi profesional bën propozimin për degradim, kurse e aprovon Zv. Drejtori;
- 8.5 Të dënuarit informohen për përmbajtjen e çdo raporti, posaçërisht për raporte disiplinore duke ju dhënë atyre mundësinë për ta përmirësuar sjelljen e tyre dhe nëse është e nevojshme të japin koment në ç'farëdo raporti;

#### Neel 38

#### Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulle, shfuqizohet dokumenti Nr.2415 datë 18/10/2012 Regjimet për të dënuar si dhe vendimi Nr.716 datës: 30/05/2018 i nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues.

#### Neel 39

#### Hyrja në fuqi

Kjo rregull e brendshme hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj rregulle është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe udhëzimet administrative në fuqi vlejnë dispozitat ligjore dhe akteve nënligjore.

Shtator 2019

Nehat Haxhi  
  
Drejtori i Përgjithshëm  
i Shërbimit Korrektues të Kosovës

